

VENDIM
Nr. 88, datë 19.5.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT DHE
PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGINËS, PËR IMPIANTIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE HEC “BANJË”, TË SHOQËRISË
“DEVOLL HYDROPOWER” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 8, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike, të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, dhe nenit 19, germa “d”, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me fillimin e procedurës për kualifikimin e impiantit dhe pajisjen me “Certifikatë të garancisë së origjinës”, për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 684 prot., datë 7.5.2020, shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me “Certifikatën e garancisë së origjinës” për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”.

- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., rezulton si më poshtë:

- Aneksi 1. Format i aplikimit, gjerat “a”, “b”, “c”: është plotësuar pjesërisht. Mungon autorizimi ose prokura e përfaqësimit të shoqërisë në këtë aplikim.

- Neni 7, pika 7.4. Kërkesa për lëshimin e garancisë së origjinës, gjerat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”, “g”: Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7.5. Dokumentacioni teknik, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”: Është plotësuar tërësisht.

- Neni 8. Procedura teknike e kualifikimit, pikat 8.1, 8.2, 8.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”, si dhe pika 8.4: Janë plotësuar tërësisht.

- Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me autorizimin ose prokurën e përfaqësimit të shoqërisë nga përfaqësuesi ligjor, në bazë të nenit 35, të “Kodit të Procedurës Administrative” (KPrA), do t’i kërkohej shoqërisë plotësimi brenda afateve të përcaktuara në “Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës, për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për kualifikimin e impiantit dhe për pajisjen me “Certifikatë të garancisë së origjinës” për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti